



**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“LELO GROUP” shpk**

**KREU 1**  
**Themelimi , Emri , Objekti, Kohëzgjatja , Selia**

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare*”, vendosëm hartimin e këtij Statuti , me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

**Neni 1**

Shoqëria **“LELO GROUP” sh.p.k.**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2- Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“LELO GROUP” sh.p.k.**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga *Alessandro Massari* i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare vetem per kapitalin themeltar te vendosur.

Ortaku i vetëm gëzon kuotën e plotë në shoqëri, sipas kontributit që ka dhënë në kapitalin themeltar .

**Neni 3- Selia**

Shoqëria Tregtare **“LELO GROUP” sh.p.k.**, e ka selinë ne qytetin e Vlorës,  
Në adresën: Lagjja:”Pavarësia” Rr; “Hektor Shyti” 9404 Vlorë. ZK. 8602. nr pošturi 2861  
Posta Elektronike: [alessandromassari76@gmail.com](mailto:alessandromassari76@gmail.com); [agronbrataj@yahoo.it](mailto:agronbrataj@yahoo.it)  
Tel; 0672737707

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqiperise, me vendim te Ortakut të Vetëm të Shoqërisë .

**Neni 4- Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Te ofroj, kryej dhe drejoje sherbime Supermarrije turistike, projekte dhe veprimitari te te gjitha llojeve që lejon legjislacioni shqiptar, në lidhje dhe në dobi të bashkëpunimit, në fushën e turizmit, tregëtisë,



biznesit, telekomunikacioneve, mjedisit, menaxhimit, konsultimeve Investimeve, Agjensive Turistike, Marketingut.

- Të ofrojë Shërbime Publicitare, Animime, Import -Eksport, Shërbime Hostes, Operator Turistik, Kopshtari, Shërbime Portineri, Ndihmë të moshuarve dhe të fëmijëve, Shitje Makinash, Shitje të produkteve farmaceutike, Këshillim Biznesi, Shitje e gjësë së Gjallë dhe Vezëve, Ristrukturim, Mirëmbajtje të Tokës, Agrikulturë dhe shërbimet e saj .
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh, Bar-Kafe, Restorantesh, Diskotekash, Qendrash Pushimi dhe Kurative, Qendrash Fitnesi, Hapje Linjash Interneti dhe venien ne sherbim te tij per te tretet.
- Te krijoje, bleje, financoj, investoj, te hyje ne maredhenie te ndryshme me te tretet, te kryej supermarrje dhe projekte te ofroj sherbime dhe asistence ne sherbim te turizmit, per persona Fizik dhe Juridik.
- Mund te marre pjese dhe te bashkepunoje edhe me shoqeri te tjera tregtare, supermarrje te cdo lloji, qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj.
- Kompania ka te drejte te Importoj, eksportoj, me shumice dhe pakice, dhe te zhvilloj cdolloj aktiviteti tregtar.
- Në mënyrë të veçantë, kompania mund të marrë kredi , te vendose hipoteka te pagueshme dhe pengje. Gjithashtu mund të japë garanci në favor të institucioneve të treta dhe bankare, brenda kufijve të përmendura më lart gjithmone ne interes te shoqërisë. Mund të marri pjesë në konsorciume, rrjete biznesi dhe ndërmarrje të përbashkëta.
- Kompania mund te beje përdorimin e të gjitha kontributeve dhe / ose përfitimet tativore të parashikuara nga ligjet e miratuara, si rajonale ashtu edhe kombëtare ose Komunitare.
- Kompania mund te zgjeroj objektin e veprimtarise ne gjithçka parashikon ligji shqiptar .

#### Neni 5- Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar.

#### KREU II

#### KAPITALI

#### Neni 6- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakut të vetëm themelues me vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë qe perben 100% te kapitalit.

**Ortaku i vetëm themelues; Z. Alessandro Massari** Zotëron (1) një kuote me vlore te per gjithshme 100 000( Njëqindmijë) LEKE qe perbene **100 % te Kapitalit Themeltar të Shoqërisë**  
Kontributi i Ortakut të Vetëm mund të jetë në para ose në natyrë (Pasuri te Luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

#### Neni 7- Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut të të Shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.



## Neni 8- Kuotat

Kuota e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Transferimi i kuotave te te tretet kufizohet me miratim te asamblese se ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

## KREU III ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE

### Neni 9- Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte i vetmi organ vendimmarres i Shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

### Neni 10- Menyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes Elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbate vandin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites, e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 ditë perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblesë.
2. Kur Asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakorte, per te marre vendime pavaresisht parregullsise.

### Neni 11- Marrja e Vendimeve

1. Asambleja e Përgjithshme me Vendim të Ortakut të Vetëm vendos për ndryshim te statutit, zmadhim ose zvogelin e kapitalit te regjistruar, Shperndarjen e Fitimeve, riorganizim dhe prishjen e Shoqerise.
2. Asambleja e per gjithshme me Vendim të Ortakut të Vetëm vendos per çështje te tjera si;



- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise. Të gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqerise regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilat nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 12- Administrimi

Administrator i shoqërisë caktohet **Agron Brataj**, i biri i Ramadan dhe i Hanife, shtetas Shqiptar, lindur më datë 15/06/1972, në Vlorë dhe banues në Vlorë, posedues i Leternjoftim ID me nr. personal H20615181L. Administratori emërohet **me afat 5 vjeçar** dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### Neni 13- Kompetencat

Organi Administrativ (Administratori) ka fuqi ne menaxhimin e rregullt te Shoqerise. Administratori ka te drejte dhe detyrohet te :

- a) Te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Të Përfaqësojë Shoqërinë tregtare;
- c) Te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Tëpërgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpëra asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) Te krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

- 
- f) Te kryejë regjistrimet dhe dërgojetë dhënët e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) Te raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrase mbledhjen e ortakeve te shoqerise dhe ne rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë pasuri, që ka vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- c) Mbledhja mund të zhvillohet në selinë e shoqërisë por edhe online në zoom, në varësi të situatës dhe vendndodhjes fizike të ortakut.

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të Huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si: Të lidh Kontrata, të kryej veprime te ndryshme Bankare, Doganore, tregtare e financiare, te punesoj dhe te pushoj nga puna personelin qe do te zgjidhet nga ai. Te realizoj cdo veprimtari tjeter kontraktore, ose jashtë kontraktore qe eshte ne interes te Shoqerise. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratori mund te emeroj perfaquesues te Posacem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh.

#### Neni 14- Përgjegjësitet

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.





Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me te kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuaara.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, vepron në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “.

#### **KREU IV**

##### **Neni 15- Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 16- Bilanci i shoqerise dhe dividentet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rrith shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

##### **Neni 17- Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve .

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergaqit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

##### **Neni 18- Fitimet**

Të ardhurat neto ( Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondevë ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, mbeten dhe kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

##### **Neni 19- Punesimet ne Shoqeri**

Per punonjesit qe do te punesohen marredheniet juridike midis Shoqerise dhe te punesarve do te rregullohen nepermjet kontrates se Punes ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.



1. Shoqeria merr persiper te derdin rregullisht te gjitha detyrimet , gjithashtu dhe kontributet per Sigurimin e te Punësuarve te saj ne organet kompetente per katese ne per puthje me dispozitat Ligjore ne fuqi

**KREU V**  
**Prishja -Riorganizimi i Shoqerise**

**Neni 20- Prishja dhe likuidimi**

*Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve te shoqerise;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaki e shoqerise marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tyre emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "*Shoqeri ne Likuidim e Siper*".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e Shoqerise.

Nëse Ortaket e shoqerise nuk marrin vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 21- Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvèçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendies së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

### Neni 22- Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

### Neni 23- Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

### Neni 24- Ndarja

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakeve te shoqerise, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërise ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pašoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta.
- b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë
- c) që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërise pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- d) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

### Neni 25- Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare Shndërrimi nuk sjell pašoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.



### Neni 26- Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

### Neni 27-Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### Neni 28- Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe, dy prej të cilave bashkëlidhen me kopje në gjuhen Italiane, dhe nënshkruhet me vullnet të lirë e të plotë nga ortaku themelues i shoqërisë

Ky Statut është hartuar sot më datë 17-02-2022

**PËR SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"LELO GROUP" sh.p.k**

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

**Alessandro Massari**



AKT - THEMELIMI  
I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**“LELO GROUP” Shpk**

**Neni 1- EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shtetasi italian:

**Alessandro Massari**, atësia Antonio, amësia Bianca, lindur në San Pietro Vernotico dhe banues në Brindisi, me adresë Via Mazzini Giuseppe n.21, lindur më 06/10/1985, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Kartë Identiteti italiane nr. CA37432JX dhe kod fiskal MSSLSN85R06I119F.  
themelon shoqerinë me përgjegjësi te kufizuar të quajtur

**“LELO GROUP” Shpk**

Kjo Shoqëri është Person Juridik në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe aktiviteti i saj rregullohet duke u bazuar ne Statutin dhe në këtë AKT THEMELIMI si dy akte bazë të kësaj Shoqërie.

**Neni 2- SELIA E SHOQERISE**

Shoqëria Tregtare **“LELO GROUP” sh.p.k.**, e ka selinë ne qytetin e Vlorës,  
Në adresën: Lagjja:”Pavarësia” Rr; ”Hektor Shyti” 9404 Vlorë  
Posta Elektronike: [alessandromassari76@gmail.com](mailto:alessandromassari76@gmail.com); [agronbrataj@yahoo.it](mailto:agronbrataj@yahoo.it)  
Tel; 0672737707  
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, me vendim te Ortakut të Vetëm të Shoqërisë

**Neni 3- KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakut të vetëm themelues me vleren 100.000 (njëqind mijë) LEKË:

**Ortaku i vetëm themelues; Z. Alessandro Massari** Zotëron (1) një kuote me vlerë te pergjithshme 100 000( Njëqindmijë) LEKE qe perbene **100 % te Kapitalit Themeltar të Shoqërisë**

Kontributi i Ortakut të Vetëm mund të jetë në para ose në natyrë (Pasuri te Luajtshme / te paluajtshme apo te drejta).

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Shoqerise në të njëjtat kushte që kërkohen përmadecën e statutit.



#### Neni 4- KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar. Do te jetë subjekt i te drejtë shqiptare nga momenti i regjistrimit te saj e deri në momentin që ortaku do të vendosin përfundimin e Shoqërise.

#### Neni 5- OBJEKTI I SHOQËRISË

Shoqëria ka si objekt të veprimitarise së saj:

- Te ofroj, kryej dhe drejtoje sherbime Sipermarrje turistike, projekte dhe veprimtari te te gjitha llojeve që lejon legjislativni shqiptar, në lidhje dhe në dobi të bashkëpunimit, në fushën e turizmit, tregtisë, biznesit, telekomunikacioneve, mjedisit, menaxhimit, konsultimeve Investimeve, Agjensive Turistike, Marketingut.
- Të ofrojë Shërbime Publicitare, Animime, Import –Eksport, Shërbime Hostes, Operator Turistik, Kopshtari, Shërbime Portineri, Ndihmë të moshuarve dhe të fëmijëve, Shitje Makinash, Shitje të produkteve farmaceutike, Këshillim Biznesi, Shitje e gjësë së Gjallë dhe Vezëve, Ristrukturim, Mirëmbajtje të Tokës, Agrikulturë dhe shërbimet e saj .
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh, Bar-Kafe, Restorantesh, Diskotekash, Qendrash Pushimi dhe Kurative, Qendrash Fitnesi, Hapje Linjash Interneti dhe venien ne sherbim te tij per te tretet.
- Te krijoje, bleje, financoj, investoj, te hyje ne maredhenie te ndryshme me te tretet, te kryej sipermarrje dhe projekte te ofroj sherbime dhe asistence ne sherbim te turizmit, per persona Fizik dhe Juridik.
- Mund te marre pjese dhe te bashkepunoje edhe me shoqeri te tjera tregtare, sipermarrje te cdo lloji, qe kane lidhje me objektin e veprimitarise se saj.
- Kompania ka te drejte te Importoj, eksportoj, me shumice dhe pakice, dhe te zhvilloj cdolloj aktiviteti tregtar.
- Në mënyrë të veçantë, kompania mund të marrë kredi , te vendose hipoteka te pagueshme dhe pengje. Gjithashtu mund të japë garanci në favor të institucioneve të treta dhe bankare, brenda kufijve të përmendura më lart gjithmone ne interes te shoqërisë. Mund të marri pjesë në konsorciume, rrjete biznesi dhe ndërmarrje të përbashkëta.
- Kompania mund te beje përdorimin e të gjitha kontributave dhe / ose përsitimet tatimore të parashikuara nga ligjet e miratuara, si rajonale ashtu edhe kombëtare ose Komunitare.

a) Kompania mund te zgjeroj objektin e veprimatrise ne gjithçka parashikon ligji shqiptar

#### Neni 6- ORGANET E SHOQËRISË

Administratori i shoqerisë do të jetë z. **Agron Brataj**, i biri i Ramadan dhe i Hanife, shtetas Shqiptar, lindur më datë 15/06/1972, në Vlorë dhe banues në Vlorë, posedues i Leternjoftim ID me nr. personal H20615181L

Administratori emerohet me afat 5 vjecar dhe shkarkohet me vendim te Ortakeve te shoqerise.

Shoqeria “LELO GROUP” shpk do të jetë subjekt i ligjit shqiptar dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislativin aktual shqiptar, Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërise, bashkëngjitur.

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 (katërt) kopje origjinale në Gjuhën Shqipe dy prej të cilave bashkëlidhen me kopje në Gjuhën Italiane.

Akt-Themelimi i Shoqërisë me përgjegjësi të Kufizuar "LELO GROUP" shpk u hartua në Vlorë më datë 17-02-2022.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

**"LELO GROUP" SH.P.K**

*z. Alessandro Massari*

*Alessandro Massari* 

Vlorë më 17-02-2022

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE VLORË**  
**NOTER VALBONA SH. MEÇAJ**



V2022062410019427407

DATE 17/02/2022

NR REP 315



**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 17-02-2022, para meje Notere VALBONA SH. MEÇAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Vlore, HAJRO ÇAKËRRI, SULEJMAN DELVINA, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUUES:**

Alessandro Massari, atësia Antonio, amësia Bianca, shtetas Italian, lindur në San Pietro Vernotico dhe banues në Brindisi, me adresë Via Mazzini Giuseppe n.21, lindur më 06/10/1985, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Kartë Identiteti italiane nr. CA37432JX dhe kod fiskal MSSLSN85R06I119F.

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitë dhe nënshkruajti përpara meje Noteres, "STATUTIN" dhe AKT THEMELIMIN e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "LELO GROUP" shpk, bashkëlidhur, këtij Vërtetim Nënshkrimi.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gëрма "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij në Statutin e Shoqërisë :"LELO GROUP" shpk

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE**

VALBONA SH. MEÇAJ

